7 të verifikojmë që është i njëjti informacion?

8 Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk e di a po shoh dokumentin e
9 gabuar po mbase Prokurorja duhet që të shohë pjesën e sipërme
10 të faqes. Nuk thotë atë që sapo tha ajo.

11 Z. REES: [Përkthim] Nëse në ekranin e provave është
12 dokumenti, të cilin përmend ajo - aty duket që është adresa e
13 internetit. Pra nuk është marrë nga një profil Facebook-u, por
14 nga një uebsajt.

15 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] E kuptoj. Po pyetja që unë i bëj
16 hetueses është nëse ka verifikuar apo jo në bazë të të dhënave
17 që ka ky artikull nëse ky artikull është shkarkuar nga profili
18 i Facebook-ut i Nasim Haradinajt.

19 Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk tha këtë Prokurorja qëparë.
20 Mbase duhet parë procesverbali, mbase duhet ta bëjë dhe
21 njëherë pyetjen.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni nuk është
23 aktivizuar për Gjykatësin].

24 DËSHMITARJA: Mund të konfirmoj se e kam parë këtë
25 artikull në llogarinë në Facebook të z. Haradinaj.

1 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

2 Py. A mund të thoni nëse artikulli në të majtë të ekranit dhe
3 në të djathtë të ekranit përmban të njëjtat fotografi dhe të
4 njëjtin informacion?

5 Pë. Unë shikoj faqen e parë -

6 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Mund të kalojmë në faqen 2 për
7 secilin dokument të paraqitur krah për krah në ekran?

8 Py. Ai që është në të djathtë mund të zvogëlohet paksa, ose
9 nëse është më konveniente në ndarjen e dosjes tuaj është
10 ndarja 19.

11 Pë. Mos ka ndonjë gabim se në ndarjen 19 nuk është kjo.

12 Py. 90, d.m.th. 90.

13 Pë. Më falni kujtova se thatë 19.

14 Pë. Faleminderit, e pashë.

15 Py. Mund të konfirmoni nëse informacioni në artikullin për të
16 cilin flisni në deklaratën tuaj dhe artikulli i shkarkuar nga
17 faqja në Facebook e z. Haradinaj është e njëjtë?

18 Pë. Po e konfirmoj.

19 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dua që t'i tregoj Dëshmitares një
20 fotografi të shkëputur nga një video, e cila është pranuar në
21 prova, me numër prove P00003 me vulë kohore 00:07.

22 [Luhet videoincizimi]

23 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit.

24 Py. Hetuese, a i njihni apo i dalloni të akuzuarit në këtë
25 fotografi të shkëputur nga video?

Dëshmitarja: Zdenka Pumper (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Bolici (Vijon)

Faqe 71

1 Pë. Po.

2 Py. Në qendër të fotografisë kush është?

3 Pë. Është z. Gucati.

4 Py. Po personi që është ulur në të djathtë të fotografisë
5 përbri me z. Gucati?

6 Pë. Është z. Faton Klinaku.

7 Py. Jeni njohur, e keni takuar ndonjëherë z. Klinaku?

8 Pë. Po.

9 Py. Me ç'rast?

10 Pë. Z. Klinaku ishte përfaqësues i Organizatës së Veteranëve
11 të Luftës kur kemi kryer kontrollimin.

12 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit. Dëshiroj që tani të
13 tregoj një fotografi tjetër të shkëputur nga një video tjetër
14 - është dokumenti nga video me numër P0007. Dëshiroj që të
15 shkoj në vulën kohore 10 minuta, 30 sekonda.

16 [Luhet videoincizimi]

17 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po, kjo është në rregull.

18 [Luhet videoincizimi]

19 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Cilado nga këto të tjerët.

20 Edhe kjo.

21 [Luhet videoincizimi]

22 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Pra vula kohore në këtë rast
23 është 15 minuta, 45 sekonda.

24 Py. A e njihni personin e paraqitur në këtë foto të shkëputur
25 nga videoja?

Dëshmitarja: Zdenka Pumper (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga znj. Bolici (Vijon)

Faqe 72

1 Pë. Po.

2 Py. Kush është ky person?

3 Pë. Është z. Tomë Gashi.

4 Py. Jeni takuar me Tomë Gashin më përpara?

5 Pë. Po, disa herë, përfshirë edhe në rastin kur ai ishte
6 përfaqësuesi ligjor gjatë kontrollimit që u bë në Organizatën
7 e Veteranëve të Luftës.

8 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dëshiroj që tani të kalojmë në
9 seancë private shkurtimisht.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Sekretar
11 do të kalojmë në seancë private.

12 [Seancë private]

13 [Seancë private teksti i fshirë]

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitarja: Zdenka Pumper (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga znj. Bolici (Vijon)

Faqe 73

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitarja: Zdenka Pumper (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga znj. Bolici (Vijon)

Faqe 74

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitarja: Zdenka Pumper (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga znj. Bolici (Vijon)

Faqe 75

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4 [Seancë e hapur]

5 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës jemi
6 në seancë publike.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
8 vazhdoni znj. Prokurore.

9 Py. Hetuese, me aq sa dini ju, punonjës të ZPS-së a kanë
10 kontaktuar dëshmitarë apo dëshmitarë të mundshëm pastaj
11 konferencave për shtyp dhe pastaj sekuestri me të dokumenteve
12 nga Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së?

13 Pë. Po.

14 Py. Po, nga e dini këtë?

15 Pë. Edhe unë kam qenë pjesë e kësaj. Kam kontaktuar dy
16 dëshmitarë vetë. Ishte një proces i organizuar shumë mirë.

17 Py. A mund të thoni se kush ishin të përfshirë nga zyra juaj,
18 duke përmendur vetëm funksionin profesional.

19 Pë. Me sa më kujtohet personat kryesorë, të cilët kanë
20 telefonuar individët ishin prokurorët në shoqërinë e hetuesve
21 dhe të punonjësit të sigurisë së dëshmitarëve.

22 Py. Si janë kontaktuar këta dëshmitarë?

23 Pë. Me sa di unë, me thirrje. Ju kërkoj ndjesë, edhe është
24 bërë takim me ta.

25 Py. Pse u kontaktuan këta dëshmitarë?

Dëshmitarja: Zdenka Pumper (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Bolici (Vijon)

Faqe 76

1 Pë. Dëshmitarët u kontaktuan si rezultat i nxjerrjes së
2 Paketave 1, 2, dhe 3.

3 Py. Dhe me ç'qëllim u bënë këto kontakte?

4 Pë. Qëllimi i kontakteve që unë bëra ishte që të kontaktoja
5 njerëzit, të bisedoja me ata se çfarë kishte ndodhur dhe të
6 kuptoja se si ndiheshin për këtë, ç'qëndrim mbanin për këtë.

7 Py. A ju kujtohet pa përmendur emra, ndonjë shembull specifik
8 i personave që keni kontaktuar, që ju ka thënë?

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

10 Prokurore e keni fjalën se kë ka kontaktuar vetë Dëshmitarja?

11 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po, ajo vetë.

12 DËSHMITARJA: [Përkthim] Personalisht kam biseduar me dy
13 individë. Njëri prej këtyre, ky person ishte shumë i
14 frikësuar, shumë i irrituar.

15 Z. REES: [Përkthim] A mund të bëj një kundërshtim?

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

17 Z. REES: [Përkthim] Ka një vendim procedural të mëparshëm
18 sa i takon bërjes së deklaratave nga të tretë, të raportuara
19 në Notat Zyrtare.

20 Unë e kuptoj që Dëshmitarja ka përmendur shkurtimisht që
21 ka kontaktuar dy dëshmitarë, por unë do parashtroja që
22 Dëshmitarja të thotë -- nëse thotë, nëse tregon se çfarë i
23 kanë thënë - kjo do të ishte në shkelje të vendimit procedural
24 që ka nxjerrë Gjykata për pranueshmërinë e këtyre provave.

25 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Nëse mundem do të thosha që unë

Dëshmitarja: Zdenka Pumper (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Bolici (Vijon)

Faqe 77

1 nuk kërkoj pranimin e dokumentacionit në këtë moment sa i
2 takon kontaktit. Thjesht po e pyes Hetuesen për përvojën e
3 saj.

4 Z. REES: [Përkthim] Po çfarë kërkohet të bëhet këtu?
5 Kërkohet që të paraqiten si provë, dëshmia e bërë nga një
6 person tjetër që i ka thënë kësaj, që i është thënë
7 Dëshmitares.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni
9 kundërshtim për dëshmi të dëgjuara nga të tretë?

10 Z. REES: [Përkthim] E kam fjalën për parashtrimin e bërë
11 dhe më përpara. Pra kur ZPS-ja kërkon që të shmangë, të
12 anashkalojë pasojat e qarta që ka Rregulli 153, 154, 155, kur
13 synon që të përdorë një regjim të qartë ose më saktë këto
14 rregulla kanë për synim të paraqesin, të ofrojnë një regjim të
15 qartë për pranimin e deklaratave të bëra nga të tretë përmes
16 dëshmisë së dhënë gojarisht në sallë.

17 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen midis
18 tyre]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Nuk ka mikrofon]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtimi
21 nuk pranohet. Dëshmitarja do të lejohet të dëshmojë. Kjo është
22 dëshmi bazuar në të dëgjuar, por sigurisht do të lejohet sipas
23 këtyre rregullave.

24 Ne e kuptojmë që është një çështje konfrontuese dhe kjo
25 do të merret parasysh.

1 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Hetuese, a mund të na thoni se
2 cilët, ç'ju ka thënë dëshmitari që ju keni kontaktuar?
3 Pë. N.q.s. mund ta përsërit. Një person konkret ishte shumë i
4 trembur dhe dëshmitari shpjegoi se ishte djegur në kuptim që
5 ishte bërë i njohur identiteti i tij nëpërmjet këtyre
6 nxjerrjeve. Më kërkoi që të kthehesha në Gjykatë dhe t'u
7 lutesha të mos e thërrisnin si dëshmitar sepse kishte frikë
8 për jetën e tij dhe të familjes. Dhe më në fund pranoi n.q.s.
9 që unë t'i thoja Gjykatës që nuk e gjeta dot dëshmitarin. Kam
10 shkruar një notë të rëndësishme për këtë.
11 Py. Faleminderit.

12 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Tani të nderuar Gjykatës do të
13 përfundoj pyetjet e mia dhe vura re se gjatë seancës kam
14 përmendur dhe një dokument tjetër që nuk është paraqitur ende
15 si provë materiale. Dokument me numër ERN SPOE00220808-
16 00220810.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Cili është ky
18 dokument?

19 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Është artikulli i dytë që iu
20 tregua Dëshmitares sot dhe u shkarkua nga profili i Facebook-
21 ut i z. Haradinaj.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
23 kundërshtim?

24 Z. REES: [Përkthim] Ka një kundërshtim. Ne do të
25 parashtrojmë se origjina e këtij artikulli nuk është

1 përcaktuar si duhet. Kërkoj që vendimi për pranimin e këtij
2 dokumenti të shtyhet kur të vijë momenti i duhur.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund ta
4 shtjelloni më tej pse mendoni që burimi nuk është i
5 përcaktuar?

6 Z. REES: Po. Sepse dukej qartë që erdhi nga gazeta
7 Ekspres, një uebsajt i njohur, jo nga Facebook-u. Nuk ka pasur
8 ndonjë deklaratë se është përgatitur përpara dëshmisë së sotme
9 që kjo zyrë ka thënë që do të ishte kështu. Ne jemi ankuar dhe
10 më përpara dhe përsërisim ankesën tonë sot.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Cadman?

12 Z. CADMAN: [Përkthim] Edhe unë jam dakord me këto që tha
13 z. Rees. E kemi ngritur dhe më herët kur u përmend Facebook-u
14 përpara drekte.

15 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen midis
16 tyre]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Origjina e
18 dokumentit, burimi pra është vërtetuar nga Dëshmitarja në
19 masën e kënaqshme, kështu që dokumenti pranohet. Sigurisht që
20 ju mund t'i bëni pyetjet tuaja për këtë çështje Dëshmitares.

21 Ndonjë tjetër -

22 Ah më fal duhet të kemi numrin, t'i japim një numër kësaj
23 prove materiale.

24 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Numri do të jetë P128 të

1 nderuar.

2 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës dua të
3 theksoj dhe njëherë kërkesën për pranimin e deklaratës dhe
4 provën materiale që shoqërohet me të sipas Rregullit 154 duke
5 theksuar sesa vendimi për këtë çështje do t'i japim mundësi
6 Prokurorisë të përcaktojë çështje të tjera që duhen adresuar
7 me këtë Dëshmitare në këtë fazë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
9 Vendimi i mëparshëm është në fuqi që do t'i japë mundësi
10 Mbrojtjes t'i bëjë pyetje Dëshmitares dhe do ta kemi parasysh
11 kërkesën tuaj.

12 Z. Rees, jeni gati të vazhdoni?

13 Z. REES: [Përkthim] Ka disa çështje administrative lidhur
14 me finalizimin e pyetjeve tona, të cilat nuk dua t'i trajtoj
15 tani, më fal, të cilat dua t'i drejtoj tani.

16 Edhe pse na janë bërë të njohura disa prova materiale nuk
17 kemi marrë vesh përpara ato që ajo do të thotë.

18 E di që është ora 3.10. Unë mund të filloj nëse ju
19 dëshironi dhe neve mund të paraqesim atë listën e provave të
20 themi ashtu siç është tani. Por nëse do të jetë e nevojshme do
21 të bëjmë shtesat përkatëse. Në këtë fazë ne duam që ta
22 ndërpresim punën këtu dhe të fillojmë nesër. Por jam në dorën
23 tuaj.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të shikoj se
25 ç'thonë kolegët.

1 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen midis
2 tyre]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Trupi
4 Gjykses, vazhdo që të bësh atë që mund të bëni. Disa janë
5 paraprake dhe pjesën më të mirë të kësaj ore mund ta përdorim
6 dhe pastaj gjatë natës ju mund ta bëni gati renditjen e
7 pyetjeve ashtu siç t'ju duket me vend.

8 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] N.q.s. më lejoni të nderuar
9 Gjykatës.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

11 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Kolegu tha që lista e
12 prezantimeve nuk është e plotë. Ne do të donim që të dëgjonim
13 atë pjesë që është e disponueshme që të mund të trajtojmë
14 ndonjë çështje që mund të dalë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duket kërkesë
16 me vend.

17 Z. Rees, keni fjalën.

18 Pyetje të palës tjetër nga z. Rees:

19 Z. REES: [Përkthim] Znj. Pumper, së pari më falni nëse
20 nuk ua them emrin si duhet. Më falni gjithashtu nëse i
21 keqshqiptoj emrat në shqip apo në serbisht. Do të përpiqem, të
22 paktën shpresoj që do t'i them aq mirë sa të jenë të
23 kuptueshme. N.q.s. ndodh që të them diçka që nuk është e qartë
24 për ju, për çfarëdo arsye më ndaloni, më kërkoni ta them dhe
25 njëherë apo ta riformuloj që ju ta keni të qartë për ta

1 ndjekur.

2 Pë. Faleminderit.

3 Py. Ju jeni hetuese me përgjegjësi të plota për hetimin e
4 kësaj çështjeje?

5 Pë. Jo, nuk jam.

6 Py. Kush është ky person?

7 Pë. Përgjegjësia e përgjithshme i takon Prokurores, në këtë
8 rast znj. Bolici.

9 Py. A ndihmohet ajo nga ndonjë hetues që me qëllim për të
10 hetuar ka përgjegjësi të plotë ndaj hetuesve të tjerë?

11 Pë. Jo, nuk është. Zyrtarisht dua të them, jo.

12 Py. Po informalisht, jo formalisht pra?

13 Pë. Kur unë e kam ndihmuar atë në këtë hetim dhe kishte dhe
14 pjesëtarë të tjerë të stafit, herë vinin herë iknin, të cilët
15 unë i kam mbikëqyrur në punën që bënin.

16 Py. Përfshirja juaj në hetim filloi kur? Kur filloi përfshirja
17 juaj në këtë çështje, në këtë hetim?

18 Pë. Unë fillova me kontrollin.

19 Py. Dhe kjo ndodhi në 25 shtator?

20 Pë. Po.

21 Py. A mund të na ndihmoni dhe të na thoni kush ishte
22 përgjegjësi, personi përgjegjës për gjithë hetimin nga 7
23 shtatori e më tutje?

24 Pë. Nuk mund t'i përgjigjem kësaj pyetje, sepse unë vetë nuk
25 jam përfshirë në atë kohë. Nuk e di kush ishte përfshirë po

1 besoj që do të ketë qenë znj. Bolici, supozoj.

2 Py. A mund të kontrolloni gjatë natës me qëllim që nesër të na
3 ndihmoni duke na dhënë një përgjigje afirmative për këtë gjë?
4 Pë. N.q.s. më lejoni dua ta sqaroj. Ju doni të mësoni se kush
5 ishte, kush përgjigjej për të gjitha apo jo një person?

6 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] N.q.s. më lejoni kam kundërshtim
7 me këtë kërkesë të Avokatit që hetuesja të mësojë informacione
8 që ajo nuk i ka në këtë kohën midis dy seancave.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Rees ju
10 duket kërkesë e...

11 Z. REES: Ajo mund të përgjigjet si dëshiron, varet nga
12 ajo. Pyetja që unë bëra është plotësisht e arsyeshme, sesi ajo
13 përgjigjet varet nga ajo pastaj.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një minutë se
15 e kisha mbyllur mikrofonin. Pyetja ishte. Pyetja iu bë juve
16 Dëshmitare. N.q.s. e dini përgjigjuni, n.q.s. nuk e dini thoni
17 jo.

18 Z. REES: [Përkthim]

19 Py. Pyetja e fundit që unë bëra ishte nëse mund të na ndihmoni
20 duke kontrolluar dokumentet gjatë natës me qëllim që nesër
21 mund të na ndihmoni me pyetjen që po ju bëj se kush kishte
22 përgjegjësi për hetimin nga data 7 shtator?

23 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Kundërshtoj.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Edhe unë bëra
25 të njëjtën pyetje. Ajo gjatë pushimit tha se gjatë natës ajo

1 do të ketë mundësi të shqyrtojë dokumentet dhe të përgjigjet,
2 të dëshmojë, kështu?

3 Z. REES: [Përkthim] Po.

4 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Unë po pyes nëse është e drejtë e
5 Avokatit t'i kërkojë Dëshmitares të kontrollojë dokumente që
6 nuk i ka, informacione që ajo nuk i di për momentin.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është e
8 pranueshme se unë e udhëzova atë të bëjë kështu. Duhet të
9 marrim një përgjigje për këtë.

10 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit të nderuar.

11 Py. A e dini se kush përgjigjej në terren nga data 7 shtator -
12 si hetuese gjithmonë flas - për të filluar hetimin në atë që
13 ka ndodhur atë ditë?

14 Pë. Cilën ditë e keni fjalën?

15 Py. 7 shtator. Dita e parë apo jo kur ZPS-ja mori dijeni, të
16 paktën kështu pretendon, kështu thotë për dokumentet që kanë
17 mbërritur në OVL-UÇK. Kjo që ishte në fakt dhe tema e
18 konferencës së shtypit që u mbajt atë ditë.

19 Pë. Nuk kam njohuri nëse është zhvilluar një hetim në terren
20 në atë ditë.

21 Py. Përsëri, a mund t'i kontrolloni dokumentet gjatë natës që
22 të na ndihmoni për këtë pikë nesër në mëngjes?

23 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Kundërshtoj për këto lloj
24 pyetjesh. Hetuesja nuk mund, -- hetueses nuk mund t'i kërkohet
25 të vejë të kontrollojë të cilat nuk i ka në posedimin e saj.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni nuk është
2 aktivizuar]
3 Py. A mund t'i kontrolloni këto dokumente që të na ndihmoni
4 për këtë çështje, për këtë pyetje nesër në mëngjes?
5 Pë. Të nderuar Gjykatës n.q.s. më lejoni, unë nuk besoj se ka
6 dokumente, procesverbale që unë mund t'i kontrolloj për të
7 parë nëse është zhvilluar ndonjë hetim në terren në atë kohë.
8 Ajo që unë mund të bëj është që të flas me stafin që kanë qenë
9 në terren, dhe t'i pyes ata nëse është zhvilluar, nëse ka
10 pasur një hetues aty.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] N.q.s. aq
12 keni për të kontrolluar është plotësisht e pranueshme.

13 DËSHMITARJA: [Përkthim] Tani që po mendoj se çfarë mund
14 të kontrolloj, kemi dokumente udhëtimi dhe nga këto dokumente
15 udhëtimi mund të kontrolloj nëse ka qenë një hetues në vend në
16 atë kohë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Rees po ju
18 pyet të shikoni nëse mund të kontrolloni. N.q.s. nuk mund të
19 kontrolloni atëherë kjo do të ishte përgjigjja juaj.

20 Z. REES: Faleminderit.

21 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dëshmitarja është udhëzuar të mos
22 flasë me stafin e ZPS-së për këtë çështje dhe kjo do të ishte
23 përjashtim nga ky rregull.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni të
25 drejtë.

1 Z. REES: [Përkthim] Po.

2 Py. N.q.s. bëni përpjekje dhe nesër na thoni që "Nuk ka
3 dokumente të cilat na ndihmojnë për të përcaktuar se kush ka
4 qenë hetuesi që e ka bërë këtë", na e thoni nesër.

5 Py. A përdorni ju shënime, emaile, përmes të cilave u dërgoni
6 udhëzime hetuesve duke i dhënë detyra për shembull: Ja kjo
7 është detyra. Shiko çfarë mund të bëni këtu. Gjëra të tilla.
8 Pë. Kemi forma të ndryshme sesi i marrim udhëzimet në punën
9 tonë, emaile, me gojë, me njoftime.

10 Py. Pra mund të na ndihmoni për t'i shikuar këto dokumente që
11 nesër të na thoni se kush ka qenë hetuesi i parë që i është
12 kërkuar të merret me këtë punë?

13 Pë. Siç thashë më përpara do të bëj çmos të shikoj nëse do të
14 mësoj diçka për këtë gjë.

15 Py. Faleminderit. Të janë bërë disa pyetje të përgjithshme nga
16 Prokurori për sistemet që ekzistojnë, që ekzistojnë në ZPS.
17 Edhe unë do t'ju bëj disa pyetje. Kur t'i shikoni këto
18 dokumente gjatë natës, sepse unë do t'ju bëj disa pyetje sesi
19 ka ecur, si është zhvilluar hetimi. Ju lutem a mund të bëni
20 çmos që të krijoni një ide të përgjithshme të këtij hetimi në
21 bazë të këtyre dokumenteve? Ju lutem mund të na ndihmoni me
22 këtë?

23 Pë. Do të përpiqem.

24 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Nuk është e qarte se çfarë
25 detyre.

1 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen midis
2 tyre]

3 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Kërkesa është e bërë nga kolegu
4 avokat është shumë e gjerë. Në fakt është një detyrë për të
5 kryer një hetim, të cilin Dëshmitarja duhet ta kryej gjatë
6 natës për t'i dhënë përgjigje Avokatit Mbrojtës. Më duket
7 është një mënyrë për t'i bërë bisht urdhrave të mëparshme mbi
8 mosnxjerrjen apo çështje që kanë të bëjnë me mosnxjerrjen të
9 lidhura me hetimin në këtë rast.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk do të
11 futemi në punën e brendshme të kësaj zyre. Po nëse ajo na
12 ndihmon për të mësuar se kush ishte përgjegjës për procesin e
13 përgjithshëm të hetimit unë do ta lejoj. Por nuk kemi ndërmend
14 të futemi në hollësi, edhe e kuptoj shqetësimin tuaj si
15 Prokurori dhe nuk ju vë faj.

16 Z. REES: [Përkthim] Unë nuk e parashikoj, nuk i
17 parashikoj dot përgjigjet e Dëshmitares por e kuptoj këtë që
18 thoni.
19 Py. Dhe në këtë fazë unë e bëra të qartë. Kam kërkuar vetëm që
20 të njiheni me një ide të përgjithshme të hetimeve që të bëj
21 pyetje për shembull në lidhje me kronologjinë, hapat e
22 ndërmarra e kështu me radhë apo jo. Do të isha mirënjohës
23 n.q.s. mund të na ndihmoni. Përpiquni.
24 Pë. Do të përpiqem.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të vazhdojmë

1 me diçka tjetër. Dëshmitarja tha se do të përpigjet. Të
2 vazhdojmë.

3 Z. REES: [Përkthim]

4 Py. Pra ju filluat, roli juaj fillon në 25 shtator. Që nga ajo
5 kohë, roli ka përfshirë dhe hetimet në sfond lidhur me
6 nxjerrjet e shtatorit 2020?

7 Pë. A mund ta shpjegoni pak më shumë se ç'do të thoni në
8 "sfond të nxjerrjes"?

9 Py. Do të jem më konkret. Roli juaj në hetime ka përfshirë
10 hetimin në procesin përmes të cilit -- ajo që është bërë e
11 njohur si me termin paketat erdhën dhe u dorëzuan në Shoqatën
12 e Veteranëve të Luftës.

13 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Kundërshtoj. Çështja pritët të
14 vendoset nga Trupi Gjykses lidhur me rëndësinë e
15 materialitetit të informacionit përmes të cilit paketat
16 arritën në OVL UÇK. Kjo çështje nuk është zgjidhur ende. Pra
17 kjo është një përpjekje për të mësuar informacione të cilat
18 aktualisht nuk janë subjekt i nxjerrjes.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'i
20 trajtojmë këto çështje së shpejti. Unë do të pranoj
21 kundërshtimin në këtë moment. Mund të vazhdoni me pyetje të
22 tjera. Mund ta ngrini në një moment tjetër.

23 Z. REES: [Përkthim] E kuptoj që ta lëmë për më vonë këtë
24 pyetje edhe pse ne vumë re se dje kur filluam këtë proces, ju
25 thatë shprehimisht se Trupi Gjykses do të lejojë pyetje nëse

1 ndonjë ish-anëtar i ZPS-së apo ndonjë palë private sipas
2 udhëzimeve apo kontrollit të ZPS-së ka dorëzuar apo ka ofruar
3 materialin në fjalë në OVL UÇK dhe jemi përgatitur
4 përkatësisht.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do tu
6 përgjigjeni këtyre më vonë. Tani është përtej pyetjeve
7 kryesore. Nuk po ju kufizoj në të ardhmen. Por tani për
8 momentin duhet të ndërmarrim disa veprime të tjera përpara se
9 ju ti bëni këto pyetje.

10 Z. REES: [Përkthim] Nuk ju kuptoj për momentin por mbase
11 do mendohem gjatë natës dhe do të shikoj se ç'do të bëjmë
12 nesër.

13 Dua të ngre një gjë lidhur me këtë pyetje. Unë nuk
14 kërkoja hollësi, doja vetëm që Dëshmitarja të konfirmonte nëse
15 është përfshirë në atë hetim, se kjo mund të ndikojë aty ku ne
16 duam të arrijmë, ku duam të shkojmë me këtë Dëshmitare.

17 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen midis
18 tyre]

19 Z. REES: [Përkthim]
20 Py. Dua të jem konkret znj. Pumper dhe pres një përgjigje
21 konkrete në këtë fazë. Përgjegjësitë tuaja për hetimin në
22 lidhje me këtë çështje filluan në 25 shtator e tutje, a
23 përfshinin ato hetimin e procesit përmes të cilit këto paketa
24 u dorëzuan në OVL UÇK?

25 Py. Kur bëme kontrollin në OVL UÇK...

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një minutë.

2 Përgjigjja kërkohet "po" apo "jo".

3 DËSHMITARJA: Po.

4 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit. Po vazhdoj dhe do të

5 mendohemi gjatë natës dhe nesër pastaj mund t'i rikthehem.

6 Py. Ju na thatë se filluat punën në TFHS në janar 2016 dhe më

7 pas shkuat, erdhët të punonit në Zyrën e Prokurorit të

8 Specializuar. Më përpara keni punuar për EULEX-in?

9 Pë. Po.

10 Py. Për sa kohë keni punuar për EULEX-in?

11 Pë. Unë fillova punë për EULEX-in në mesin e 2009-s.

12 Py. Pra pesë vite?

13 Pë. Po, pesë vite.

14 Py. Pra për një periudhë të konsiderueshme kohe e keni pasur

15 qendrën në Prishtinë, kështu?

16 Pë. Po.

17 Py. Dhe aty je takuar me shumë njerëz besoj që po ashtu

18 punonin në Prishtinë, e kishin qendrën në Prishtinë në atë

19 kohë?

20 Pë. E keni fjalën për anëtarët e stafit të EULEX-it? Unë isha

21 anëtare e EULEX-it?

22 Py. E TFHS-së anëtare?

23 Pë. Jo.

24 Py. A kishte anëtarë të stafit të ZPS-së në Prishtinë?

25 Pë. Gjatë kohës time në EULEX?

1 Py. Jo. Që nga momenti që ti fillove të punosh për EULEX-in në
2 2009-n.

3 Pë. Ndërkohë që kam punuar për EULEX-in nuk kam takuar asnjë
4 person që ishte pjesë e TFHS-së.

5 Py. A ka pasur anëtarë të tjerë të komunitetit tuaj atje në
6 Prishtinë që jeni takuar gjatë asaj kohe?

7 Pë. E ke fjalën për kosovarë apo e ke fjalën për
8 ndërkombëtarë?

9 Py. Për kosovarë.

10 Pë. Po, jam takuar me shumë prej tyre.

11 Py. Po ndërkombëtarë?

12 Pë. Po edhe me ndërkombëtarë jam takuar.

13 Py. Gjatë kohës tuaj me TFHS-në edhe ZPS-në, ju keni punuar
14 ngushtë me zyrtarë të tjerë. A keni punuar pra ngushtë me
15 zyrtarë të tjerë të këtyre organizatave?

16 Pë. Të ZPS-së, të TFHS-së dhe EULEX-it?

17 Py. Ju pyeta më përpara për TFHS-në por edhe me të tjerë?

18 Pë. Po, kam punuar ngushtë, kam punuar ngushtë me stafin e
19 tyre të TFHS-së.

20 Py. Gjatë kohës tuaj me TFHS-në dhe ZPS-në, a jeni takuar me
21 zyrtarë serbë?

22 Pë. Besoj që jam takuar në dy ose tre raste me zyrtarë serbë.

23 Py. A keni patur korrespondencë me zyrtarë serbë?

24 Pë. Nuk e mbaj mend.

25 Py. A keni zhvilluar marrëdhënie të ngushta me ndonjë zyrtar

1 serb?

2 Pë. Jo nuk kam pasur marrëdhënie të ngushta.

3 Py. Nga kolegët tuaj në TFHS dhe të ZPS-së, a jeni në dijeni
4 të tyre d.m.th. të kolegëve që kishin korrespondencë me
5 zyrtarë serbë?

6 Pë. Po.

7 Py. Dhe që takoheshin me zyrtarë serbë?

8 Pë. Po.

9 Py. Dhe ndonjë koleg i juaj në TFHS dhe në ZPS a ka ndërtuar
10 marrëdhënie të ngushta me zyrtarë serbë?

11 Pë. Të lutem a më shpjegon pak se çfarë do të thuash me
12 marrëdhënie të ngushta?

13 Py. E kam fjalën për marrëdhënie të ngushta pune.

14 Pë. Nuk jam në dijeni të kësaj.

15 Py. Po marrëdhënie profesionale?

16 Pë. Ajo çfarë kuptoj unë me marrëdhënie profesionale janë
17 kontakte me subjekte të ndryshme.

18 Py. A ka pasur kolegë të tuaj që kanë punuar në mënyrë të
19 rregullt me zyrtarët serbë?

20 Pë. Jo në dijeninë time.

21 Py. A kanë pasur marrëdhënie personale për të cilat ju jeni në
22 dijeni?

23 Pë. Jo në dijeninë time.

24 Py. Më lejoni t'ju pyes rreth konfidencialitetit. A jeni
25 dakord, a pajtoheni ju që dokumente, informacione duhet të

1 klasifikohen si konfidenciale kur është e nevojshme për ta
2 bërë një shënim të tillë?

3 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, avokati po
4 pyet Dëshmitaren për opinionin e vet dhe nuk mendoj që detyra
5 e Dëshmitares është që të japë opinionin e vet për dokumentet.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

7 Z. REES: [Përkthim] A mund t'ju shpjegoj ju lutem se pse
8 e bëra këtë pyetje?

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

10 Z. REES: [Përkthim] Kjo Dëshmitare sigurisht pretendon që
11 ka parë dokumente të cilat janë shënuar si konfidenciale. Unë
12 dua që të eksploroj më tej se kjo Dëshmitare e kupton
13 konfidencialitetin, por kjo Dëshmitare ka shprehur pikëpamjet
14 e veta për shumë, shumë dokumente, pjesa dërrmuese të cilëve,
15 ose ju, ose unë, ose çdo person tjetër në këtë gjyq ose në të
16 paktën të sallës së gjyqit i ka parë. Dhe për këtë arsye doja
17 që të dija, që të kuptoja sesi e kuptonte Dëshmitarja termin
18 konfidencial, pra shënimin konfidencial në dokumente.

19 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen midis
20 tyre]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo
22 Dëshmitare nuk ka dhënë dëshmi lidhur me kuptimin e
23 konfidencialitetit, por ajo ka dëshmuar lidhur me
24 identifikimin e dokumenteve të cilat kanë indicie për
25 konfidencialitetin. Ajo nuk ka dhënë asnjëherë dëshmi se çfarë

1 nënkupton kjo dhe si ka shkuar aty, kështu që ose duhet që të
2 parafrazonit dhe njëherë pyetjen, për shembull mund të bëni
3 pyetjen sesi ka mbërritur në përfundimin se këto dokumente
4 ishin konfidenciale, por nuk mund të futeni në hollësi sa i
5 takon pjesës së përkufizimit.

6 Z. REES: [Përkthim]

7 Py. Znj. Pumper, kur keni bërë rishikimet tuaja, a e keni
8 konsideruar si me rëndësi shqyrtimin nëse nevoja e kërkesës
9 për indicie të konfidencialitetit të dokumentit është e
10 rëndësishme?

11 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës e kundërshtoj
12 këtë pyetje. Kjo pyetje shkon përtej fushës së marrjes
13 kryesisht në pyetje të Dëshmitares. Dëshmitarja ka dhënë
14 dëshmi rreth rrethanave faktike të dokumenteve, jo rreth
15 opinionit të saj sa i takon nevojës për klasifikimin si
16 konfidencial të dokumenteve.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranoj. Pra
18 duhet ndoshta që të bëni një pyetje ndryshe ose një linjë
19 tjetër pyetjesh n.q.s. doni që të flisni për
20 konfidencialitetin, por asnjëherë nuk do të arrij tek opinioni
21 se çfarë është e nevojshme sa i takon informacionit
22 konfidencial.

23 Z. REES: [Përkthim] E kuptoj. Nuk është synimi im që të
24 nxjerr, le të themi, përgjigjen e pyetjes që bëra unë për
25 Dëshmitaren në fjalë dhe ta marr atë si dëshmi eksperti për

1 ligjin.

2 Megjithatë kjo Dëshmitare është ngarkuar me detyrën në
3 mungesë të mosnxjerrjes së shumë shumë faqeve material që të
4 bëjë rishqyrtimin dhe të identifikojë atë se çfarë është
5 parashtruar nga ZPS-ja si faktorë të rëndësishëm për juve për
6 tu shqyrtuar nga këto dokumente pa i parë vetë dokumentet.

7 Dhe për pasojë dëshiroj që të bëj disa pyetje për të
8 përcaktuar se çfarë niveli kuptimi ka ajo, d.m.th. nuk është
9 se ka ndonjë peshë tjetër përveçse të ndihmojë për të
10 identifikuar se cilët janë faktorët që ajo ka përdorur për të
11 bërë shqyrtimin e dokumenteve, kjo është detyra.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk është
13 ajo, nuk është kjo pyetje që po bën. Ti po bën pyetjen se
14 çfarë, cili është kuptimi i fjalës konfidencialitet dhe kjo
15 nuk është pjesë e detyrave të saj dhe nuk do ta lejoj këtë
16 pyetje.

17 Atëherë kundërshtimi pranohet. Juve e dhatë qëndrimin
18 tuaj, kështu që vijoni më tej ju lutem.

19 Z. REES: [Përkthim]

20 Py. A konstatuat ju nevojën e klasifikimit të ndonjë dokumenti
21 si konfidencial si një faktor të rëndësishëm kur keni bërë
22 shqyrtimin tuaj?

23 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, e njëjta
24 pyetje është e bërë me fjalë të ndryshme, kështu që vazhdojmë
25 me kundërshtimin e kësaj pyetjeje.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

2 Z. REES: [Përkthim]

3 Py. Përcaktimi ose identifikimi i një dokumenti si
4 konfidencial nuk duhet të përdoret apo jo që të ndalohet
5 turpërimi i një personi?

6 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Kundërshtim.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbase është
8 mirë që së pari të pyesni a e di ajo, se çfarë, se cili është
9 prezumimi?

10 Z. REES: [Përkthim]

11 Py. N.q.s. jeni në dijeni të faktit se dikush e ka caktuar një
12 dokument si konfidencial për të anashkaluar një situatë të
13 sikletshme, a do ta konsideronit këtë si faktor material në
14 shqyrtimin tuaj?

15 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kjo është
16 një pyetje e cila është tërësisht hipotetike dhe shkon në të
17 njëjtën rrugë të pyetjes që u mundua disa herë të bënte
18 avokati.

19 Pra me këtë rast do të doja që të shënoja që nuk e kemi
20 marrë këtë prezantim të Mbrojtjes.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyetja çon në
22 të njëjtën gjë. Po kërkon një opinion dhe këtë opinion nuk
23 është e cilësuar që ta japë, nuk është e kualifikuar që ta
24 japë Dëshmitarja.

25 Z. REES: [Përkthim] Në rrethanat në fjalë unë do të doja

1 që të reflektonim për konstatimet e bëra deri tani dhe besoj
2 se mund të kursejmë kohë n.q.s. lejojmë, lejoni që të kemi
3 kohën e nevojshme. Kështu që n.q.s. do ta na lejonit do të
4 ishte mirë që të mendonim për linjën e pyetjeve dhe pastaj të
5 fillojmë nga e para nesër në orën 9 e gjysëm.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të merreni
7 atëherë me këtë pyetje gjatë natës, këtë po thoni apo jo?

8 Z. REES: [Përkthim] Po.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë
10 faleminderit. Ju lutem shoqëroheni Dëshmitaren jashtë sallës.

11 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në lidhje me
12 prezantimin, me rrjedhën e prezantimeve n.q.s. do të ketë
13 probleme për ngarkimin e tyre në Legal Workflow do t'ju
14 informojmë për çdo lloj gjëje.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull
16 është kjo për juve?

17 Në rregull.

18 E mbyllim për sot. Nesër në mëngjes do të fillojmë në
19 orën 9.30. Seanca mbyllet për ditën e sotme.

20 --- Seanca mbyllet në orën 15.41 pasdite

21

22

23

24

25